

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Iu fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më **22 shkurt 2018 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 25.01.2018;
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2017;
3. Rishqyrtimi i vendimit të kuvendit të komunës lidhur me emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa Nr. 01.23/18, i datës 25.01.2018;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2018;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve;
8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen në shëndetësi;
9. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018;
10. Të ndryshme.

Bashkëngjitur me ftesë iu dërgojmë rekomandimet e KPF-së dhe materialet për të gjitha pikat e rendit të ditës.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -I- E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR
MË 25 JANAR 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxfhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z.Xhafer Tahiri, Nënkryetari i komunës z.Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Para fillimit të diskutimeve për rendin e ditës, dhanë betimin anëtarët e rinj të kuvendit: Kushtrim Hyseni, Agim Bregaj, Faton Shabani dhe Basri Menxhiqi, të cilët u bënë anëtarë me të drejta të plota.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit – njoftoi kuvendin se anëtarja e kuvendit Arta Imeri, ka parashtruar në sekretarinë e kuvendit një deklaratë me të cilën informon se tani e tutje do t'i takojë grupit kuvendar të LDK-së.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – njoftoi se në saje të një takimi në zyrën e kryetarit të komunës, kishin tentuar të gjejnë një modus lidhur me përcaktimin e çelësit për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, por ajo nuk është arritur për faktin se propozimi i bërë nuk ishte në pajtueshmëri me ligjin, andaj për këtë ai kërkoi që pika 7 dhe 8 të hiqen nga rendi i ditës dhe për këtë të kërkohet interpretim ligjor nga MAPL-ja.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – duke iu referuar pikës në të ndryshme, paraqiti vërejtje për qeverinë komunale, për shkak të asaj se materiali qysh në mbledhjen e parë ishte vonuar sa i përket pikës: Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, megjithatë ai deklaroi se këtë pikë do ta përkrahin. Lidhur me takimin e që kishin tek kryetari i komunës, ai theksoi se nëse është e nevojshme LB-ja mund të tërhiqet nga

kërkesa e saj për të qenë pjesë e KPF-së, mirëpo rregullativa juridike siç është LVL-ja dhe udhëzimi administrativ përcaktojnë se në Komitetin për Politikë dhe Financa përfaqësimi duhet të shtrihet në të gjitha entitetet politike të përfaqësuara në kuvend.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit – arsyetoi se pika në të ndryshme është ofruar për kuvend, pas procedimit të materialit, me qëllim që granti për projektin në fjalë të mos humbet, kjo pikë është proceduar në këtë formë.

Xhafer Tahir, Kryetar i komunës – pasi iu uroi suksese anëtarëve të rinj të kuvendit, sqaroi se në takimin në zyrën e kryetarit, asgjë nuk është diskutuar jashtë suazave ligjore dhe shtoi se në referim të ligjit dhe udhëzimit administrativ, ku kërkesa e ligjit është jo përfaqësim proporcional, por përfaqësim të të gjitha entiteteve politike të përfaqësuara në kuvend sa i përket përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa. Andaj sipas propozimit të dhënë apo formulës që u diskutua në zyrën e kryetarit, përfaqësimi do të ishte i 32 anëtarëve nga 35 sa i ka kuvendi i komunës. Në fund kërkoi nga kuvendi që të ketë një dakordancë sa i përket propozimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - propozoi që në pikën në të ndryshme të futet propozimi për themelimin e grupit joformal të grave në kuvendin e komunës.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se kishte me qenë mirë që të konsultohet MAPL-ja lidhur me pikën kontestuese për çelësin e themelimit të KPF-së, pasi që nuk dëshiron që në mbledhjen e parë të kuvendit të ketë mospajtime mes pozitës dhe opozitës, andaj kërkoi që propozimi për themelimin e KPF-së të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe për këtë të merret opinioni ligjor i MAPL-së.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se e mbështet diskutimin e parafolësit, dhe shtoi se grupit kuvendar të PDK-së si grupi më i madh politik në kuvend, i takojnë tre (3) anëtarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, por nëse një anëtar i jepet LB-së, atëherë prapë do të ishte në rregull dhe kjo nuk do të paraqiste ndonjë problem. Në fund ai ceku dhe apeloj për një koordinim më të mirë të grupit kuvendar të PDK-së për çështje që janë objekt shqyrtimi në kuvendin e komunës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – njoftoi se shefe e grupit kuvendar të LVV-së do të jetë znj. Bahrije Ademi Murati.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - njoftoi se shef i grupit kuvendar të LDK-së, është caktuar të jetë z. Shkelzen Feka.

Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit – njoftoi kuvendin se shef i grupit kuvendar nga radhët e AAK-së, është caktuar z.Lutfi Bilalli.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se duke u bazuar në legjisllacionin në fuqi, termi grup parlamentar nuk është i sanksionuar, mirëpo termi grup kuvendar është i përcaktuar me Statutin e komunës, andaj në situatat kur kemi konflikt mes dispozitave të ligjit dhe statutit, atëherë përparësi në zbatim do të kenë dispozitat e ligjit.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – tha se kanë ndërtuar një koalicion më të gjerin që njeh historia e pasluftës e Komunës së Vushtrrisë, dhe krejt kjo me të vetmin qëllim që Komunës së Vushtrrisë t'i sigurojmë një stabilitet politik, një qasje dhe qeverisje ndryshe. Tutje shtoi se shtyrja përpara e agjendës qeverisëse kërkon bashkërendim të aktivitetëve të gjithsecilit bartës të funksioneve publike dhe të zgjedhurve nga ana e qytetarëve, andaj ai pret nga secili që të punojnë bashkë në interes të qytetarit të Komunës së Vushtrrisë. Në vazhdim ai paraqiti një rezyme lidhur me të emëruarit në drejtoritë komunale: ku ceku se Nënkryetar i Komunës është emëruar z.Bsim Muzaqi, z. Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë; z. Afrim Namani, drejtor i Drejtorisë për Arsim; z. Bajrush Kosumi, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim; z. Berat Asllani, drejtor i Drejtorisë për Inspektive; z. Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit; znj. Fatmire Cecelia, drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport; z. Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa; z. Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë për Administratë; z. Miran Halili, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural; znj. Saranda Cakaj, drejtoreshë e

Drejtorisë për Prokurim Publik; z. Sedat Rashica, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe z. Sylejman Mehulli, drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të PDK-së deklaroi se tërhiqen nga propozimi që të hiqen nga rendi i ditës pikat 7 dhe 8, andaj propozoi që vazhdohet me procedimin e rendin e ditës ashtu si është ofruar nga ana e kryesuesit të kuvendit.

Pas debatit lidhur me rendin e ditës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mënyrë “unanime” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës i datës 28.09.2017;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e kuvendit i datës 20.12.2017;
3. Shqyrtimi i Draft-planit i punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Kryetarit të komunës për vitin 2018;
5. Shqyrtimi i Raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
6. Shqyrtimi i Planit të veprimtari mbi rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
8. Shqyrtimi i propozimeve për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës;
9. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
 - b). Shqyrtimi i propozimit për themelimin e grupit joformal të grave deputete.

1.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës i datës 28.09.2017

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 28.09.2017.

2.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e kuvendit, i datës 20.12.2017

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja inauguruese e kuvendit, e datës 20.12.2017;

3.Shqyrtimi i Draft-planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së - propozoi që raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, në muajin korrik të emërtohet raport gjashtëmujor, në muajin tetor raport nëntëmujor, kurse në muajin dhjetor të emërtohet raport vjetor.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018, me propozimin e parashtruar më lart.

4. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Kryetarit të komunës për vitin 2018

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – tha se Plani i Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2018, është bërë publik në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, por edhe në mediat lokale, në mënyrë që të marrim sa më shumë impute nga qytetarët tanë, ashtu që të bëjmë një plan sa më të kompletuar. Qeverisja e re e Komunës së Vushtrrisë ka për synim parësor rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së shërbimeve të komunës për qytetarin. Me këtë plan synoj të ofroj një shans të barabartë për të gjithë qytetarët e komunës, i cili është një udhërrëfyes për një komunë të hapur dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e saj. Kryetari i komunës i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me LVL-në, Statutin e Komunës së Vushtrrisë, vendimet e kuvendit dhe aktet tjera nënligjore, gjithnjë duke pasur parasysh interesin për komunën dhe qytetarin. Tutje shtoi se plani i punës shërben si dokument bazë për punën njëvjeçare të kryetarit të komunës dhe të qeverisjes komunale. Si dokument është një reflektim i angazhimit të vazhdueshëm për t'i kanalizuar nismat për planifikim të objektivave, përkatësisht prioritetëve të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të vitit 2018, e që ka për qëllim final përmirësimin e cilësisë së jetesës për të gjithë qytetarët në komunën tonë. Ky plani i punës përmban objektiva afatgjate, përmes të cilave synohet të vihen themelet e transformimit të qytetit në një qytet modern, por që ruan traditën dhe identitetin e vetë, kurse realizimi i tyre do të fillojë në vitin 2018, por që përmbyllja e tyre do të marrë kohën e vetë. Mandej plani përmban projekte konkrete, si dhe veprime specifike si në administratë ashtu edhe në infrastrukturë, por që janë pashmangshëm të ndikuara nga planifikimi buxhetor i qeverisjes së kaluar, i hartuar dhe i aprovuar në vitin paraprak. Pastaj vlerësoi se ky plan ka edhe kufizimet e veta ku ndër kryesoret është se planifikimi buxhetor është bërë nga qeverisja e kaluar, andaj si rezultat i kësaj disa nga pikat e këtij plani do mund të realizohen vetëm pas muajit qershor kur do të bëhet rishikimi i buxhetit të komunës. Përmbushja e këtij plani natyrisht se i ka edhe sfidat e veta, por beson që me një angazhim të përbashkët të të gjithëve mund të arrihen rezultate konkrete dhe kështu të përmirësohet cilësia e shërbimeve në komunë, por edhe të përmirësohet mirëqenia e qytetarit. Po ashtu ky plan paraqet prioritetet kryesore të kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për periudhën njëvjeçare dhe jep përmbledhje të objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara dhe realizimin e tyre duke i përcaktuar edhe afatet kohore për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara, por i cili plan përgjatë vitit 2018 është dinamik dhe mund të plotësohet gjatë gjithë vitit duke synuar arritjen e objektivave të reja. Në vazhdim ai njoftoi kuvendin se ndër prioritetet kryesore të këtij plani janë të përmbledhura gjithsej në dyzetë pika, e të cilat si më kryesoret janë: menaxhimi transparent dhe efektiv i buxhetit të komunës, rritja e të hyrave vetanake, transparenca në shpenzime dhe llogaridhënia, efikasiteti lidhur me punën e organeve të komunës, digjitalizimi i shërbimeve në administratë, eliminimi i pritjeve të qytetarëve për të marrë dokumentet që i kërkojnë nga komuna, realizimi i të hyrave të planifikuara buxhetore dhe të gjitha formave dhe mundësive të burimeve të tjera të të hyrave për komunën, rritja e të hyrave vetanake të komunës, furnizimi me ujë në qytet dhe fshatra, angazhimet për funksionalizimin e zonës ekonomike (parkut të biznesit) në fshatin Lumadh, inicimi i studimit të fizibilitetit për Qendrën historike të Vushtrrisë, inicimi i studimit të fizibilitetit për tregun për prodhuesit vendorë në Komunën e Vushtrrisë, ngritja e cilësisë në arsim, ngritja e sigurisë dhe luftimi i dukurive devijante në shkolla, ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, investimet në bujqësi me qëllim të rritjes së prodhimitarisë bujqësore dhe përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve, rritja e vetëpunësimit, modernizimi i bujqësisë përmes organizimit të trajnimeve dhe këshillimeve profesionale, dhe subvencionimet e drejta për bujqit e komunës sonë, përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe start-up me qëllim të rritjes së vetëpunësimit dhe zhvillimit ekonomik në komunë, funksionalizimi i Qendrës inovative të Vushtrrisë, avancimi i infrastrukturës sportive, organizimi i festivalit të kulturës dhe diasporës “Viciania” organizimi i panairit të patates,

organizimi i praktikës për të rinjtë, inicimi i planit pesëvjeçar për adresim të strehimit për familjet pa strehim, zbatimi i kriterëve ligjore dhe nevojave të qytetarëve në urbanizëm, vendosja e rendit dhe ligjit në ndërtimet e larta në qytet, fillimi i zbatimit të pagesës për shpenzimet e varrimit për qytetarët e komunës sonë, implementimi i planit për pastërti në qytet, heqja e monopoleve, hapja e tregjeve dhe futja e konkurrencës në tregun e menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë, reduktimi i shpenzimeve dhe shpenzim racional i shpenzimeve të mjeteve publike, raportim të rregullt në kuvendin e komunës lidhur me të hyrat e komunës, realizimin e projekteve kapitale sipas afateve kohore, angazhim për shpenzimin njëqind për qind të mjeteve buxhetore në kategorinë e investimeve kapitale, sidomos të mjeteve të grantit qeveritar, me qëllim të zhvillimit të qytetit, intensifikimi i bashkëpunimit me organet e pushtetit qendror në implementimin e projekteve, të cilat janë paraparë të financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, në veçanti projektet dyvjeçare dhe trevjeçare (posaçërisht përmendi ndërtimin e objektit të Qendrës së Kulturës, e cila rrezikohet të humbet si projekt pasi që procedurat e prokurimit janë përfunduar, por nuk ka pasur zotim të mjeteve të duhura financiare nga Ministria e Kulturës). Pastaj në plan janë përcaktuar masat për lirimin e pronave të uzurpuara, si dhe angazhimi për gjetjen e investitorëve sidomos në lëmin e bujqësisë, implementimi i sistemit për ujitje nga hidro-sistemi “Ibër lepec” në fshatrat Samadrexhë dhe Pantinë, mbrojtja e pyjeve, rritja e hapësirave gjelbëruese, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në zonat rurale, por edhe në qytet, angazhimi për gjetjen e investitorëve për investime për ndërtimin e kolektorit kryesor buzë lumit “Silnica” dhe impiantit për përpunimin e ujërave të zeza në qytet, menaxhimi më i mirë i mbeturinave, duke marrë për bazë planin për menaxhimin e mbeturinave, ofrimin e shërbimeve sa më cilësore sa i përket shërbimeve nga gjendja civile, ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, avancimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive, ofrimi i mbështetjes për klubet sportive dhe organizatat rinore, bashkëpunimi me organet e nivelit qendror me ministritë e linjës në aspektin e zbatimit të ligjshmërisë, bashkëpunimi me KFOR-in dhe Policinë e Kosovës në aspektin e sigurisë së përgjithshme dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile. Në fund tha se të gjitha afatet dhe kostot financiare janë paraparë në formë tabelare dhe ftoi kuvend që ta mbështesë këtë plan.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se paragrafi i tetë i këtij plani ku thuhet se qeveria aktuale është e kufizuar për shkak se qeverisja e kaluar e ka bërë planifikimin e buxhetit, sipas mendimit të tij është i pavend dhe kjo është bërë me qëllim që në rast të dështimit të përmbushjes së këtyre projekteve, atëherë të fajësohet qeveria e kaluar. Tutje vlerësoi se duhet të kemi specifikim të projekteve, sidomos ato të rrjetit të kanalizimit dhe jo ato të jepen në shuma kumulative, e më pastaj ato të orientohen sipas parimit politik dhe partiak. Mandej njoftoi se sipas sistemit të adresave të gjitha rrugët e komunës janë të emëruara dhe tani ofrohen projekte si p.sh rrugët në fshatin Bivolak dhe nuk dihet se për cilat rrugë bëhet fjalë, andaj në këtë kontekst kërkoi që këto gjëra të precizohen saktë me qëllim që më vonë mos të ketë mundësi të manipulimit në orientimin e projekteve.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – vlerësoi se plani i punës së kryetarit është një plan mirë i strukturuar dhe si i tillë del të jetë i kompletuar dhe për këtë shprehu përgëzime për kryetarin e komunës. Në vazhdim ceku se cilësia në arsim dhe shëndetësi, plani për pastërtinë e qytetit, hapja e tregjeve dhe futja e konkurrencës në tregun e menaxhimit të mbeturinave në komunë, duhet të shpallen si prioritet i lartë. Mandej shfrytëzimi racional i drejtë dhe i ligjshëm i pronave (tokave dhe objekteve) në pronësi të komunës përmes dhënies në shfrytëzim, me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe të krijimit të vendeve të reja të punës, dhe rritjen e të hyrave buxhetore. Lirimi i pronave të komunës, të cilat janë të uzurpuara, duhet gjithashtu të jenë prioritet për qeverisjen komunale, dhe për këtë duhet të ngritën kapacitetet në drejtorinë gjegjëse. Pastaj duhet të bëhet rritja e subvencioneve në lëmin e bujqësisë, por gjithashtu duhet të ngritën mekanizmat e monitorimit të këtyre subvencioneve, si dhe të shikohet efekti praktik i këtyre subvencioneve në ndikimet në gjenerim ekonomik dhe punësim. Në fund tha se sa i

përket fushës së shëndetësisë është mirë që përveç grantit specifik të shëndetësisë të kemi rritje të mjeteve për këtë qëllim, ashtu që të bëhet ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit – propozoi që në plan të futet si pikë subvencionimi i nënave shtatzëna dhe fëmijëve të porsalindur, kjo të bëhet me qëllim të ngritjes së natalitetit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se qeveria e kaluar ka hartuar dhe aprovuar buxhetin e komunës, dhe planifikimi i hartimit të këtij buxheti është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe për këtë është ndërtuar një bazament i shëndetshëm për vijimësinë e realizimit të projekteve të ardhshme. Tutje ai duke iu referuar pikës së 19 të planit, ku bëhet fjalë për fillimin e zbatimit të pagesës për shpenzimet e varrimit për qytetarët e komunës, ceku se vendimi për këtë çështje është marrë nga mandati i kaluar dhe janë planifikuar mjetet financiare nga kodi ekonomik përkatës për realizimin e këtyre shërbimeve, por si duket kemi ngecje në këtë drejtim. Çështje tjetër mjaft shqetësuese është se edhe përkundër faktit se janë paraparë mjete për realizimin e transportit të nxënësve, deri më tani nuk kemi asnjë aktivitet të prokurimit për realizimin e këtyre shërbimeve. Në vazhdim ai paraqiti të dhëna statistikore për secilin kod ekonomik dhe për secilën kategori ekonomike, duke shtuar se këto mjete janë planifikuar dhe aprovuar nga qeveria e kaluar, por tani në këtë moment duke marrë për bazë përbërjen e kësaj qeverie, vlerësoi se do të jetë tepër sfiduese realizimi i projekteve. Tutje vlerësoi se modeli aktual i qeverisjes është unik për qytetin pasi që siç tha ai “janë bashkuar të gjithë humbësit e zgjedhjeve dhe po qeverisin komunën”. Pastaj ai vlerësoi se deri në momentin kur po flasim, qeveria, përkatësisht Drejtoria e Prokurimit nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet të prokurimit, dhe kjo seriozisht e vë në dyshim realizimin e projekteve. Lidhur me ndërtimin e objektit të Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” ceku se të gjitha procedurat e prokurimit janë përfunduar, është përzgjedhur operatori ekonomik dhe në bazë të marrëveshjes që ka komuna me Ministrinë e Kulturës mjetet do të alokohen në faza dhe se ky projekt do të përfundohet. Mirëpo në rast se komuna refuzon ta nënshkruajë kontratën lidhur me këtë projekt, atëherë do t’i bartë konsekuencat për shkak se operatori ekonomik do ta padisë komunën. Në fund tha se është skeptik në kapacitetet që ka qeveria aktuale dhe shtoi se do të dëshironte që gjërat të ishin më mirë, por në të njëjtën kohë shprehu se është i gatshëm që të japë kontributin e tij që gjërat të shkojnë më mirë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se plani i punës i kryetarit të komunës është ky që është, dhe ai bazohet në planifikimet e mëhershme buxhetore, dhe për këtë qeveria aktuale e ka një lehtësi në realizimin e projekteve. Tutje shtoi se pas gjashtëmujorit të parë kjo qeveri do të mund ta rishikojë buxhetin edhe eventualisht të bëjë ndonjë ndryshim. Pastaj ceku se në faqen 5 të këtij plani, ku janë paraparë blerja e disa makinave, për të cilat propozoi që këto mjete të shfrytëzohen për rregullim të objekteve shkollore, për faktin se kjo do të ishte më e arsyeshme. Në fund tha se vërejtjet e bëra është mirë që të merren për bazë, me qëllim që të kemi një plan sa më të mirë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – tha se ky dokument do të ishte mirë të lekturohet me qëllim që kur të publikohet të jetë i spastruar nga gabimet teknike. Pastaj në faqe 11, furnizimi i bibliotekave me libra, propozoi që këto biblioteka të furnizohen me lektyra shkollore që janë obligative për nxënësit. Mandej përzgjedhja e librave duhet të bëhet nga profesionistë për faktin se me zhvillimin e shoqërisë njerëzore edhe kërkesat e nxënësve për këto libra ndryshojnë. Në kategorinë furnizimi me pajisje për shkolla, propozoi që të futet edhe furnizimi me libra i bibliotekave të shkollave. Në fund tha se duhet të bëhet specifikimi i projekteve (asfaltimi i rrugëve), dhe në këtë duhet të ketë qasje edhe kuvendi i komunës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – duke iu referuar vlerësimeve se në qytetin e Vushtrrisë po qeverisin humbësit, ceku se sikur në ndeshjet sportive ku loja zhvillohet në pjesë dhe pjesa e dytë zakonisht është vendimtare, andaj edhe në rastin e qeverisjes në Vushtri ka rezultuar që pjesa e dytë të jetë vendimtare. Tutje shtoi se është mirë që në plan është përfshirë komponentja për ngritjen e cilësisë në arsim, kurse kjo bëhet vetëm duke u angazhuar të gjithë mekanizmat që janë kompetentë për këtë çështje. Pastaj ai informoi kuvendin se që nga viti 2008 ka shkolla

në komunën tonë që nuk i kanë të themeluar këshillat e shollës. Për këtë kërkoi që këta mekanizma të themelohen konform rregullativës juridike në fuqi. Sa i përket specifikimit dhe orientimit të projekteve kapitale, atëherë një rol me rëndësi duhet të kenë edhe këshillat e fshatrave për faktin se këto forume janë zgjedhur në mënyrë demokratike dhe në të shumtën e rasteve këto këshilla janë apolitik, andaj është e udhës që të merret mendimi i tyre gjatë vendosjes së projekteve. Në fund ai kërkoi sqarime lidhur me një rrugë, e planifikuar të rregullohet e cila thuhet se kalon nga fshati Stanoc i Epërm në fshatin Lumadh Prelluzhë-Gracë dhe se kjo lidhje nuk mund të ketë logjikë për shkak se kjo rrugë nuk mund të lidhë këto fshatra pa kaluar në fshatin Stanoc i Poshtëm. Gjithashtu ai shprehu keqardhje se në fshatrat Stanoc i Epërm, Stanoc i Poshtëm, Lumadh dhe Gracë nuk është planifikuar asnjë rrugë të ndërtohet kur kihet parasysh fakti se këto janë bashkësitë më të mëdha lokale.

Mehmet Selaci, drejtor i Drejtorisë së Administratës - tha se kur flasim për Drejtorinë e Administratës, ku janë përfshirë sektori i gjendjes civile, Zyra për punë të përbashkëta dhe IT, Qendra për shërbim për qytetarë, por nuk është përfshirë edhe Zyra për barazi gjinore dhe drejta të njeriut, andaj kërkoi që edhe kjo të përfshihet në plan.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit – tha se nëse shikohet ky plan dhe aktivitet që janë caktuar, del se kryetari i komunës ka përcaktuar tjera aktivitete dhe prioritete që janë të përcaktuara me ligj, statut, e që hyjnë në fushën e përgjegjësi të drejtorive komunale, por edhe në kompetencat ekzekutive të kryetarit të komunës të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Në fakt në këtë plan është dashur të kemi një përshkrim veç e veç të përgjegjësi të drejtorive komunale dhe në kumulativ të kemi një plan unik të qeverisë komunale, ashtu që mos të kemi aktivitete të ndara në dysh, aktivitete tjera kryetari i komunës, dhe tjera aktivitete drejtoritë komunale. Bazuar në buxhetin e komunës për vitin 2018, ku janë përcaktuar mjetet për secilën organizatë buxhetore dhe zyrat tjera, ku në këtë plan është përfshirë lista e buxhetit për secilën drejtori komunale, në Drejtorinë e Prokurimit është dhënë lista e përgjithshme e projekteve, kurse në drejtoritë tjera janë përshkruar tjera prioritete që dallojnë nga ato të planifikuara në buxhet. Andaj për këtë propozoi që këtij plani t'i bashkëngjitet edhe buxheti i komunës me të gjitha projektet kapitale për vitin 2018. Mandej ceku se në këtë plan duhet të futet edhe analiza e tokës për faktin se ky projekt është premtuar në fushatën zgjedhore nga kryetari i komunës. Gjithashtu propozoi që në plan të inkorporohet edhe subvencionimi për ujitjen e tokës që do të ndikonte në rritjen e rendimentit për bujqit tanë. Kur bëhet fjalë për kompetencat e komunës si person juridik, këtu përfshihet edhe Zyra e auditorit të brendshëm, në plan askund nuk është përmendur se cilat do të jenë aktivitetet e kësaj zyre, apo cila do të jetë lidhja e kryetarit të komunës në raport me auditimin e brendshëm, gjë kjo që rregullohet me Ligjin për Auditimin e Brendshëm. Në plan duhet të inkorporohet edhe aktivitetit i Zyrës për barazi gjinore. Në faqe 45 të këtij plani kontrolli i ligjshmërisë në sektorin e ndërtimit ku janë planifikuar kontrole në muajin mars dhe prill, për këtë propozoi që kjo të jetë permanent dhe mos të kemi kufizim në kohë, sepse nëse vetëm në këta muaj do të kemi ndërmarrje të masave, atëherë do të shkaktohen probleme të mëdha për komunën. Në fund tha se në faqen 54 të planit ku janë përshkruar përgjegjësitë e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, propozoi që këto përgjegjësi të renditen afër drejtorive tjera komunale.

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit – tha se plani i punës dallon nga programi, dhe shtoi se ky plan është mjaft voluminoz ku janë adresuar shumë objektiva, të cilat janë planifikuar të realizohen. Tutje shtoi se me këtë plan rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet çështjeve ambientale, dhe atyre të higjienës nëpër lokalet ku konsumohet ushqimi për shkak se këto interferojnë në instancë të fundit në shëndetin e qytetarëve tanë. Pastaj ai vlerësoi se polarizimet jo ekstreme mes pozitës dhe opozitës janë të shëndetshme dhe ato kontribuojnë në kultivimin e vlerave dhe ngritjen e vetëdijes në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Në fund ai deklaroi se e mbështet në parim planin e punës të kryetarit për vitin 2018.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së - duke u bazuar në planin e punës së kryetarit, pjesa ku flitet për fushën e shëndetësisë, rekomandoi që të bëhet harmonizimi i afateve kohore sa i

përket realizimit të projekteve kapitale në lëmin e shëndetësisë me planin e Drejtorisë së Prokurimit dhe planin e rrjedhës së parasë, për faktin se ka ndryshim të afateve kohore. Në fund ai u shpreh se pa dashur të bëjmë anime politike, në planin e kaluar në lëmin e shëndetësisë ka pasur ide të mira siç është ideja për kontrolle sistematike shëndetësore nëpër shkolla, mandej edukimi shëndetësor dhe ide tjera për cilat ai përçoi përgëzime.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – pasi shprehu falënderimin e tij ndaj grupit kuvendar të PDK-së për konstruktivitetin dhe mbështetjen e dhënë për planin e punës, shtoi se pa dashur të polemizojë, vlerësoi se ka qenë praktikë jo e mirë në të kaluarën që projektet kapitale qoftë në rrugë apo në infrastrukturë në përgjithësi kanë shkuar në kuvend si kumulativ apo të paspecifikuara. Tutje ai ceku se detyrën si kryetari i komunës e ka pranuar më datë 20 dhjetor, dhe ka qenë një kohë shumë e kufizuar për hartimin e një plani ku do të adresoheshin të gjitha temat, për këtë ceku se rasti më eklatant është ai i rrugës në fshatin Stanoc i Epërm e referuar nga një anëtar i kuvendit. Në vazhdim ai vlerësoi se planifikimi i buxhetit për vitet ardhshme nuk do të bëhet sikur është bërë nga qeveria e kaluar, kur nga një shumë simbolike e mjeteve financiare është shpërndarë nëpër fshatrat e komunës e që në realitet me ato mjete nuk ka mundur të përfundohet asnjë projekt në mënyrë të mirëfilltë. Ngritja e cilësisë në arsim do të jetë prioritet i lartë dhe për këtë u zotua para kuvendit, këtë e dëshmon fakti se para se të hartohet ky plan ai është konsultuar me një grup të mësimdhënësve të komunës sonë. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë së varrimit njoftoi se gjatë ditës së sotme do të nënshkruhet memorandumi me Këshillin e Bashkësisë Islame në Vushtrri. Transporti i nxënësve është një çështje e përfunduar ku tenderi tashmë është dërguar për shpallje dhe kjo çështje do të përmbillet shumë shpejt. Sa i përket investimeve në bujqësi koncepti i qeverisjes aktuale dallon nga ajo e së kaluarës, p.sh kostoja financiare e projektit për ujitjen e tokës është 100.000,00 € dhe tani ky projekt nuk mund të figurojë në planin e punës për faktin se mungojnë mjetet, porse ato do të planifikohen në saje të rishikimit të buxhetit. Për projektin analiza e tokës, është duke u angazhuar në gjetjen e donatorëve të huaj, në këtë rast njoftoi se tani komuna jonë ndodhet në një garë për përfitimin e një donacioni në vlerë prej 200.000,00 € nga USAID-i amerikan për bujqit e Vushtrrisë, në kultura të reja që nuk janë kultivuar deri më tani, kurse kriteri kryesor për përfitimin e këtij donacioni do të jetë analiza e tokës dhe përkrahja profesionale për ta. Sa i përket projekteve për studimin e fizibilitetit të tregut dhe fizibilitetin për Qendrën historike të qytetit, këto projekte do të mund të financohen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa sa i përket qendrës së kulturës deklaroi se nuk do të lejon që ky objekt të rrënohet pa u siguruar buxheti për përfundimin e këtij projekti, pavarësisht se kush i ka zhvilluar procedurat në një periudhë tepër të ndjeshme të këtij projekti si njëri ndër projektet më kapitale të Qytetit të Vushtrrisë. Pastaj ai sqaroi se në memorandumun e lidhur mes Komunës së Vushtrrisë dhe Ministrisë së Kulturës thuhet se kjo e fundit do t'i sigurojë 300.000,00€ për ndërtimin e qendrës së kulturës, kurse në Ligjin e buxhetit janë planifikuar vetëm 50.000.00 € dhe ky planifikim e rrezikon seriozisht përfundimin e këtij projekti.

5.Shqyrtimi i Raportit tremujor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

6.Shqyrtimi i Planit të veprimit mbi rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm

7.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit – propozoi çelësin apo formulën e përbërjes të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe atë dy anëtarë nga radhët e PDK-së, dy anëtarë nga radhët e LVV-së, dy anëtarë nga radhët e LDK-së, një anëtar nga radhët e AAK-së dhe një anëtar nga radhët e LB-së. Por në këtë kontekst ai kërkoi nga subjektet politike që ta respektojnë parimin e përfaqësimit gjinor.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të PDK-së, tha se përkundër faktit se si grup politik iu takojnë tre anëtarë në KPF, por për hir të debllokimit të situatës, atëherë ata do të marrin pjesë në votim, dhe për anëtar të KPF-së ai propozoi Shpëtim Zhegrovën dhe Melihate Basholli-Latifin.

Bahrije Ademi Murati - në emër të grupit kuvendar të LVV-së propozoi që pjesë e Komitetit për Politikë dhe Financa të jenë Fjolla Ujkani dhe Ymer Haradinaj.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së propozoi që pjesë e Komitetit për Politikë dhe Financa të jenë Rrezarta Krasniqi dhe Shkelzen Feka.

Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të AAK-së propozoi Lutfi Bilallin për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit – propozoi Nezir Klinakun për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të Kuvendit të Komunës së Vushtrri, në këtë përbërje:

1.1 Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së;

1.2 Shpëtim Zhegrova, anëtar (PDK);

1.3 Melihate Basholli, anëtare (PDK);

1.4 Fjolla Ujkani, anëtare (LVV);

1.5 Ymer Haradinaj, anëtar (LVV);

1.6 Rrezarta Krasniqi, anëtare (LDK);

1.7 Shkelzen Feka, anëtar (LDK);

1.8 Lutfi Bilalli, anëtar (AAK);

1.9 Nezir Klinaku, anëtar (LB).

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

8. Shqyrtimi i propozimeve për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - propozoi që Qerim Selimi nga radhët e opozitës të jetë anëtar i komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës.

Bahrije Ademi Murati - propozoi që Gresa Muli nga radhët e pozitës të jetë anëtare e komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 25 janar 2018, pas shqyrtimit të propozimeve për formimin e Komisionit komunal për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimet për nxënës, konform Rregullores për Ndarjen e Bursave Nr.86/15 e datës 30.04.2015, ka aprovuar propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të këtij komisioni nga radhët e kuvendit, dhe atë znj. Gresa Muli nga radhët e pozitës, kurse z. Qerim Selimi nga radhët e opozitës.

9. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202034-00018-0, me kulturë arë e klasës së 5 (pestë), në sipërfaqe prej 300 m² të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme 3469 m² sipas projektit konceptual të prezentuar nga byroja projektuese, Zona Kadastrale Zagorë, pronë e Suzanë Maqastenës.

2. Qëllimi i lejitimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale, të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit ekonomik P+0 për kultivimin-përpunimin dhe paketimin e bimës së “Aronisë”.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij vendimi, do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën “b” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

b). Shqyrtimi i propozimit për themelimin e grupit joformal të grave deputete

Gresa Muli, anëtare e kuvendit – tha se është mirë që ky grup joformal të funksionalizohet, dhe që këtij grupi t’i ndahet një fond i caktuar, me të cilin do të mund që t’i ushtrojë detyrat e veta, si dhe do t’i financonte nevojat dhe aktivitetet në adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me gratë anëtare të kuvendit të komunës.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit – sqaroi se anëtarja më vjetër e kuvendit duhet të thërras një mbledhje të grupit të grave asambleiste, në ç’rast do të zgjidhet kryetarja e këtij grupi dhe tani ky grup joformal do të mund të zhvillonte aktivitetin e tij.

ç). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – pyeti kryetarin e komunës, se në cilën fazë ndodhet implementimi i vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për shërimin e Olta Tërrstenës,

vendim i cili është marrë vitin e kaluar dhe tani kjo familje ka nevojë që kjo ndihmë financiare të realizohet sa ma parë.

Xhafer Tahiri, Kryetar i komunës – tha se është i njoftuar me vendimin e marr lidhur me rastin të cilin e potencoi anëtari i kuvendit, dhe shtoi se është i çuditshëm fakti se ai vendim është marrë që mjetet të sigurohen qoftë nga kategoria e subvencioneve apo nga mallrat dhe shërbimet, e që dihet fakti se kategoria e mallrave dhe shërbimeve kanë një procedurë tjetër të transferimit të mjeteve dhe kjo sigurisht se ka shkaktuar një problem. Gjithashtu i çuditshëm është edhe fakti se nga muaji shtator e deri më tani ky vendim nuk është zbatuar nga organi kompetent. Pastaj ai sqaroi se qeverisja e kaluar nuk e ka zbatuar atë vendim dhe buxheti për vitin 2017 është përmbyll, andaj ky vendim ka mbetur të zbatohet me mjetet financiare të këtij viti, dhe në këtë formë dikush do të privohet nga e drejta për të marrë ndihmë financiare për shërim në kuadër të buxhetit komunal për vitin 2018.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se është e vërtetë që të gjithë anëtarët e kuvendit në mënyrë unanime e kanë votuar këtë vendim për ndihmë financiare, duke e ditur që nuk ka mjete financiare, mirëpo qëllimi ka qenë që në çdo formë t'i dilet në ndihmë kësaj familjeje, dhe vendimi është aprovuar ashtu që nëse do të ketë mjete në vitin 2017 a është dashur të realizohet në të kundërtën a duhet të realizohet këtë vit.

Mbledhja përfundoi në ora 13:35.

Bastri Duraku

Nasuf Aliu

Procesmbajtës

Kryesues i Kuvendit

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police	
	Drejtoria Rajonale e Policisë / Mitrovicë Regionalna Policijska Direkcija / Regional Police Directorate Stacioni Policor Vushtrri Policijska Stanica Vučitern / Police Station Vushtrri	

MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM

PËR: ZA: TO:	z. Nasuf ALIU Kryesues i kuvendit komunal Vushtrri	Data: Datum: Date:	30.01.2018
PËRMES: PREKO: THROUGH	Kapiten Muhamed Alidema Komandant i Stacionit Stacioni Policor Vushtrri	Nr. i Referencës: Br. Referencije: Reference No:	04/1-02 VSH-O /013 / 18
PREJ: OD: FROM:	Toger Shaban Salih Zëvendëskomandant Stacioni policor Vushtrri		
LËNDA: PREDMET: SUBJECT:	Raporti i sigurisë për vitin-2017		

I nderuar Kryesues z.ALIU.

- Gjendja e sigurisë në zonën e përgjegjësisë të Vushtrrisë është stabile dhe kënaqshme. Gjatë vitit 2017, është shënuar ngritje e numrit të rasteve sidomos të veprave penale në krahasim me vitin e kaluar, Pjesërisht është përmbushur objektivi në ndriçimin e rasteve.
- Veprimet tona dhe angazhimi i zyrtarëve Policor është i fokusuar kryesisht në parandalimin e krimit dhe në zbulimin e rasteve, kemi vazhduar me avancimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimin e aktiviteteve me institucione, forumet e sigurisë, organizatat jo qeveritare po ashtu kemi vazhduar avancimin e bashkëpunimit edhe me qytetar.
- Gjatë këtij viti njësia e hetimeve pran stacionit policor ka arrit të identifikoj disa grupe të personave të dyshuar të cilët kan kryer kryesisht vepra penale kundër pasurisë, siç janë: Vjedhjet, Vjedhjet e renda dhe Grabitjet, e po ashtu ka arrit të gjejë dëshmitë(sendet) e vjedhura dhe të ju kthej pronarëve legjitim.
- Trafiku
Kemi marrë një sërë aktiviteteve në sensibilizimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve (pjesëmarrësve në trafik) për respektimin e rregullave dhe dispozitave që dalin nga ligjit mbi komunikacionin rrugor. Aktivitetet më të rëndësishme janë: Fushatat për vetëdijesim përmes shpërndarjes së fletushkave për pjesëmarrësit në trafik, Propozimet dërguar Drejtorisë përkatëse në nivel të komunës rreth vendosjes së sinjalizimeve dhe shenjave të trafikut, vendosjes së pengesave etj. Si dhe shtimi i prezencës policore në rrugë dhe ndëshkimi i kundërvajtësve në vazhdimësi sidomos për kundërvajtjet që paraqesin rrezik për pjesëmarrësit në trafik. Si rezultat i angazhimit të përbashkët me drejtorinë përkatëse për trafik në nivel të komunës por edhe si rezultat i vetëdijesimit të qytetarëve kemi reduktim të aksidenteve, mirëpo mbetet ende të punohet në përmirësimin e gjendjes në trafik.

- Rastet (veprat penale dhe kundërvajtjet)

Në krahasim me vitin e kaluar kemi ngritje të theksuar të numrit të rasteve në krahasim me vitin paraprak. Rastet që kanë ndikuar në ngritjen e përgjithshme të numrit të rasteve, janë rastet si në vijim:

1. Rastet e narkotikëve janë dyfishuar si rezultat i angazhimeve shtesë të zyrtarëve policor, sipas planeve operative sidomos sipas planit operativ, i cili ka pasur për qëllim parandalimin e përdorimit dhe të shpërndarjes së substancave narkotike në dhe për rreth shkollave, pa u kufizuar vetëm në shkolla.
2. Rastet e aksidenteve me lëndime të lehta trupore, pasi deri në muajin shtator është marr NJTR-së, me këto raste, ndërsa pas ndryshimit të një udhëzimi administrativ kanë kaluar në kompetencë të stacioneve policore
3. Rastet e armëve kanë shënuar ngritje edhe këto raste vlerësojmë se janë shtuar si rezultat i angazhimeve shtesë të zyrtarëve policor.
4. Vjedhjet e rënda dhe tentim vjedhjet, janë rastet që kanë shënuar me së shumti ngritje edhe përkundër shumë angazhimeve dhe rezultateve konkrete në parandalimin dhe në zbulimin e kryerësve të këtyre rasteve, prapë këto vepra penale kanë shënuar ngritje të theksuar. Gjatë vitit-2018, parandalimi dhe reduktimi i veprave penale kundër pasurisë mbetet një ndër objektivat kryesor për të gjithë zyrtarët policor të stacionit policor Vushtrri.

- Veprat penale kundër narkotikëve

Bazuar nga informacionet e pranuar nga zyrtarët policor kemi marr aktivitete shtesë në parandalimin e përdorimit dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, sidomos jemi fokusuar në afërsi të shkollave të mesme, në rrugët “Pandeli Sotiri” dhe “Marin Barleti” tek kafiteritë si dhe në pushimoret përgjatë lumit Terstena. Gjatë vitit 2017, kemi hasur në 29 raste 46 persona të dyshuar të cilët kanë pasur në posedim substanca narkotike dhe pajisje për përdorimin e tyre, substancat narkotike janë konfiskuar dhe ndaj të dyshuarve janë iniciuar rastet në konsultim me prokurorin e shtetit.

- Siguria në shkolla

Zyrtarët policor në rroba civile por edhe njësitë e rregullta policore janë angazhuar gjatë gjithë vitit në përmbushjen e objektivave të Policisë për ofrimin e një ambienti të sigurt shkollor për nxënës, mësues, prind dhe mysafirë të rastit në të gjitha shkollat e mesme dhe fillore të komunës së Vushtrrisë. Në përgjithësi është arritur qëllimi në këtë drejtim pasi nuk janë shënuar raste të rënda dhe ka pasur rënie të tyre, gjithsej janë raportuar 11 raste të lëndimeve trupore, prishjeve të rendit dhe qetësisë publike, vjedhjeve etj. Përveç aktiviteteve operative nga Policia e Kosovës përkatësisht nga zyrtarët policor të stacionit policor Vushtrri janë mbajtur edhe ligjëratat nxënësve të shkollave të mesme dhe fillore të komunës së Vushtrrisë.

- Temat e ligjëruara:

1. Delikuenca e të miturve, Vetëdijesimi në lidhje me Dhunën, Duhanin, Drogën dhe Alkoolin
2. Vetëdijesimi për siguri në trafik
3. Vetëdijesimi për siguri në internet/ngacimet përmes internetit
4. Policia në bashkësi

- Aktivitetet tjera policore në parandalimin e sjelljeve devijuese nga nxënësit (të miturit)

1. Kontrolli i mjeteve të transportit publik
2. Plani siguria në shkolla
3. Si dhe veprime tjera operative

- Rastet me motive ndëretnike
Gjatë vitit 2017, në zonën e përgjegjësisë së Vushtrrisë nuk ka pasur të raportuar asnjë rast me motive ndëretnike.
- Implementimi i planeve operative me përkushtim maksimal. Plani operativ “ Sezoni verore-2017” është plan gjithë përfshirës, që fokusohet në parandalimin e të shtënave me arme zjarri neper ahengje, Shtimi i aktiviteteve në trafik. Ky plan operativ ka përfunduar me 02.10.2017 dhe nga 15.11.2017, ka filluar implementimi i planit operativ “Sezoni Dimror-2017-2018” po ashtu edhe ky plan është gjithëpërfshirës me qëllim të parandalimit të gjitha dukurive negative me fokus trafikun, konkretisht shtimin e kontrollit në trafik ndaj të gjithë pjesëmarrësve, kontrollimin e pajisjeve dimërore të nevojshme për automjete etj.
- Po ashtu kemi shtuar angazhimin në teren duke hartuar planin operativ “Parandalimi i veprave penale kundër pasurisë” në nivel të stacionit policor, zyrtarët policor të stacionit Policor përfshi këtu edhe eproret nga stafi komandues në vazhdimësi në dy muajt e fundit, janë angazhuar në orar fleksibil duke punuar edhe gjatë natës me qëllim të përkrahjes së ekipeve në detyrë në drejtim të parandalimit të veprave penale sidomos atyre kundër pasurisë, kohë pas kohe është vepruar së bashku me NJ.R.SH-në duke mbajtur pika të kontrollit, në lokacione të ndryshme sidomos në ato lokacione ku konsiderohen pika të zeza, ku përveç se është bërë matja e shpejtësisë së automjeteve dhe kontrolli me alkooltest i vozitësve, është bërë edhe legjitimimi verifikimi kontrollimi i personave dhe automjeteve, me qëllim të shtimit të sigurisë dhe po ashtu, detyrë e të gjithë zyrtarëve Policor pavarësisht në çfarë detyrë janë të angazhuar, është mbledhja e informatave inteligjente në interes të sigurisë publike dhe në interes të sigurisë së të gjithë qytetarëve.
- Disa nga planet me të rëndësishme që i kemi zbatuar gjatë vitit-2017, janë planet operative për sigurimin e zgjedhjeve. Tri palë zgjedhje, nacionale, lokale dhe balotazhi. Të gjitha aktivitetet dhe tubimet e partive politike gjatë fushatës zgjedhore, janë monitoruar dhe siguruar nga zyrtarët policor të sp-Vushtrri, e po ashtu në ditën e zgjedhjeve janë siguruar të gjitha qendrat e votimit. Po ashtu janë monitoruar dhe siguruar të gjitha manifestimet e simpatizantëve të partive politike pas procesit të numërimit të votave. Të gjitha proceset zgjedhore kanë kaluar pa ndonjë incident apo problem që do t'i kishte dëmtuar këto procese zgjedhore. Krejt kjo është arrit falë angazhimit të madh të gjithë zyrtarëve policor e sidomos falë vetëdijesimit të qytetarëve.
- Orari fleksibil, është përshtat angazhimi i zyrtarëve policor varësisht prej nevojave në teren, në vazhdimësi janë angazhuar edhe njësi policore për të patrulluar këmbë sidomos në Sheshin “Hasan Prishtina”, Bulevardin “Adem Jashari” dhe në rrugën “Pandeli Sotiri” kah kefiteritë , në periudhën kohore kur ka frekuentim të madh të qytetarëve në këto rrugë.
- Sifdat
Qentë endacak , është shtuar numri i qenve endacak nëpër qytet dhe në fshatra. Në lidhje me këtë dukuri kemi pranuar me dhjetëra ankesa nga qytetarët të cilat i kemi adresuar në drejtorinë përkatëse pran kuvendit komunal. Duke marr parasysh shqetësimin e qytetarëve për fëmijët e tyre që shkojnë në shkollë dhe rrezikohen nga qentë endacak, ne kemi angazhuar kohe pas kohe një njësi të përkujdeset në mëngjes në afërsi të shkollës “Naim Frashri” për tu përkujdesur për sigurinë e nxënësve.
- Raste të raportuara 2017: 1378
- Zbulimi i të gjitha rasteve 2017- 64.8 %
- Zbulimi i veprave penale 2017:-61.7 %
- Urdhëresat e gjykatës 2017-338
- Gjobat-tiketata e shqiptuara 2017-1763

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministry of Local Government Administration
 Nr. 020-147/2
 07.02.2018
 -VI-



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Nasuf Aliu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Kopje	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmos:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Fatos Qerimi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 31/01/2018 Nr. 020/147
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
 I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:


Vendim Nr. 23/18 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa
I miratuar më datë më datë: 25.01.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.01.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendim Nr. 23/18 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.	Vendimi Nr. 23/18 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa me të cilin është përcaktuar përbërja e KPF-së prej 9 anëtarëve është në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore për shkak të <i>“Mos përfaqësimit të barabartë të femrave në këtë trup ndihmues të punës së kuvendit”</i> . Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore në nenin 6 pika 7 dhe 8 ka obliguar se: <i>“Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”</i> . Lidhur me këtë qështje jeni njoftuar paraprakisht nga MAPL, me shkresën Nr. 013-1515 të datës 18.12.2017.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 51.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 54 të Statutit të Komunës së Vushtrisë, si dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2018 mori këtë:

**VENDIM
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KPF-së**

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të Kuvendit të Komunës së Vushtrri, në këtë përbërje:

- 1.1 Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së;
- 1.2 Shpëtim Zhegrova, anëtar (PDK);
- 1.3 Melihate Basholli, anëtare (PDK);
- 1.4 Fjolla Ujkani, anëtare (LVV);
- 1.5 Ymer Haradinaj, anëtar (LVV);
- 1.6 Rrezarta Krasniqi, anëtare (LDK);
- 1.7 Shkelzen Feka, anëtar (LDK);
- 1.8 Lutfi Bilalli, anëtar (AAK);
- 1.9 Nezir Klinaku, anëtar (LB).

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.


3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Për KPF-në dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues: Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës

Hartues: Lutfi Gërguri, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Tema: Propozim-vendim

Në mbështetje të nenit 12.2, pika "d", nenit 40.2, pika "c" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 9, pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-020 të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018, si dhe në bazë të nenit 41.2, pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrias në mbledhjen e mbajtur më datë _____ 2018 mori këtë:

VENDIM PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2017 NË VITIN 2018

1.Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe mëditje	1,253.99 €
1.2 Mallra dhe shërbime	91,427.70 €
1.3 Shpenzime komunale.....	21,640.12€
1.4 Subvencione dhe transfere.....	55,000.00€
1.5 Investime kapitale	821,639.11
Totali i mjeteve të bartura	990,960.92€.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

Arsyetim

Pasi që këto mjete financiare nga të hyrat vetanake nuk janë shfrytëzuar gjatë vitit fiskal 2017, dhe me qëllim që këto mjete të barten në vitin 2018, konform Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, kërkojmë nga kuvendi që të aprovojë këtë propozim-vendim për bartjen e këtyre mjeteve.

Lutfi Gërguri



Drejtore i DBF-së

Bartja e mjeteve të pashpenzuarra nga viti 2017 në vitin 2018

Komuna e Vushtrisë

Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi funksional	Fondi Burim or	Kategoria ekonomike	Nën-kategorit ekonomike (zërat)	Kategoria	BARTJA 2018
Arsini i mesëm	94890	922	22	11		Paga dhe mëditje	1,253.99
Paga dhe mëditje							1,253.99
Zyra e kryetarit	16024	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	4,330.51
Administrata - Vushitri	16324	0133	22	13		Mallra dhe shërbime	7,837.68
Çështjet gjinore	16624	0412	22	13		Mallra dhe shërbime	1,187.61
Inspeksioni	16647	0411	22	13		Mallra dhe shërbime	1,980.27
Zyra e Kuvendit Komunal	16924	0111	22	13		Mallra dhe shërbime	4,077.64
Buxhetini	17524	0112	22	13		Mallra dhe shërbime	500.00
Infrastruktura publike	18184	0451	22	13		Mallra dhe shërbime	3,999.64
Zjarrefiksat dhe inspektivitet	18428	0320	22	13		Mallra dhe shërbime	1,132.40
Bujësi	47024	0421	22	13		Mallra dhe shërbime	281.60
Planifikimi Urban Inspeksioni-Vushitri	66425	0620	22	13		Mallra dhe shërbime	6,188.51
Shëndetësia -administrata	73033	0760	22	13		Mallra dhe shërbime	686.05
Shëndetësia -shërb. shënd. primare	74450	0721	22	13		Mallra dhe shërbime	33,795.59
Shërbimet sociale	76616	1040	22	13		Mallra dhe shërbime	1,524.59
Shërbimet Kulturore	86024	0820	22	13		Mallra dhe shërbime	695.86
Administratë-Arsini	92120	0980	22	13		Mallra dhe shërbime	2,179.25
Arsini parafillor - Qerdhja	92670	0911	22	13		Mallra dhe shërbime	16,224.55
Arsini I Mesëm	94890	0922	22	13		Mallra dhe shërbime	4,805.95
Mallra dhe shërbime							91,427.70
Infrastruktura publike	18184	0451	22	14		Shpenzime komunale	20,000.00
Arsini parashkollor dhe qerdhë	92670	0911	22	14		Shpenzime komunale	1,640.12
Shpenzime komunale							21,640.12
Zyra e Kryetarit	16024	0111	22	20		Subvencione dhe transfere	5,000.00
Shërbimet Kulturore	86024	0820	22	20		Subvencione dhe transfere	50,000.00
Subvencione							55,000.00
Kapitale							821,639.11
TOTALI							990,960.92

Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2017 në vitin 2018

Komuna e Vushtrisë

Programi	Kodi i nën-programit	Kodi i funksionit	Fondi Burimor	Kategori ekonomike	Nën kategori (zerat)	Pershkrimi i nënzentit	Kodi i projektit	Projektet	BARTJA 2018
ADMINISTRATA-VUSHTRRI	16324	0133	22	30			43889	Teknologji Informative	10,000.00
ADMINISTRATA-VUSHTRRI	16324	0133	22	30			43890	Inventar për Objektin e Ri të Komunës	17,230.00
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			41406	NDËRTIMI I RRUGËVE ME KUBZA BETONI	43,381.43
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			41413	NDRIQIMI PUBLIK	1,455.76
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			41415	NDËRTIMI I KANALIZIMEVE	59,389.71
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			43900	Projektet në bashkëfinancim me donator	116,201.55
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			45049	RIASFALTIMI I RRUGËS VUSHTRRI - SLLATINË	18,966.00
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			45203	RREGULLIMI I VARREZAVE	5,000.00
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			41914	ZGJERIMI DHE ASFALTIMI I RR. KARAOE	10,000.00
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			90224	NDËRT. RRJETIT TE UJESJELLSIT	32,953.60
Infrastrukturë Publike	18184	0451	22	30			45117	Rrënimt i objekteit të Komunës dhe rregullimi i oborrit	17,229.83
Bujësi pylltari dhe zhvillim rural	47024	0421	22	30			45270	MBULIMI I NORMAVE TË INTERESIT PËR BIZNESET	100,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45249	ASFALTIMI I RRUGËS DËSHMORËT E DRUARIT	2,300.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45302	45302 ASFALTIMI I RRUGËS MATIRËT E DRUARIT	5,500.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45491	ASFALTIMI I RRUGËS "HASAN TIKU SHABANI"	2,985.22
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45516	*ASFALTIMI I RRUGËS VËLLEZËRIT VESELI	543.77
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45535	ASFALTIMI I RRUGËS "REXHEP RRAHMANI" KOLLË	5,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45572	ASFALTIMI I RRUGËS "AHMET ADEMI"	2,155.55
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45578	ASFALTIMI I RRUGËVE LOKALE NË BEÇUK	6,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45583	ASFALTIMI I RRUGËVE LOKALE NË ZHILVODË	4,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45598	ASFALTIMI I RRUGËS "SHEFOET ISA"	904.38
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45643	ASFAL. I RR. (LAGJA ISLAMI) NË FSHATIN TARAXHË	3,400.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45648	ASFALTIMI I RRUGËS RRUSTEM MEHMETI	4,978.75
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45681	ASFALTIMI I RRUGËS "SEFER MEHANA"	3,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			45683	ASFALTIMI I RRUGËS "HYSEN HAJRIZ" BALINCË	15,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			86183	ASFALTIMI I RRUGËVE DESHMORËT E KOMBIT	15,000.00
Planifikimi urban dhe inspeksioni	66425	0620	22	30			IRI	ASFALTIMI I RR. TË KONTRAKTUARA	48,000.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	30			45279	NDËRTIMI I LAPIDARËVE	15,000.00
Shërbimet kulturore	85024	0820	22	30			45343	NDËRTIMI I QENDRËS SË KULTURËS	200,000.00
Administrata e Ajsimit	92120	0980	22	30			IRI	MEREMETIMI I SHKOLLAVE	52,063.56
Ajsimi filior	93690	0912	22	30			IRI	NDËRTIMI I FUSHAVE SPORTIVE	4,000.00
TOTAL KAPITALE									821,639.11



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Datë: 13.02.2018

Për: Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues: Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës

Hartues: Lutfi Gërguri, Drejtor i DBF-së

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40.2 pika "c" e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale lidhur me nenin 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës, nenit 8.2 të Rregullores për Subvencione 01.Nr.37-2/11 e datës 24.02.2011 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.270/17, i datës 28/09/2017 me të cilin aprovohet Buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____ 2018, mori këtë:

**VENDIM
PËR SHPËRNDATRJA E MJETEVE FINANCIARE NGA SUBVENCIONET DHE
TRANSFERET PËR VITIN 2018**

1.Me këtë vendim bëhet ndarja e mjeteve financiare nga subvencionet dhe transferet për vitin 2018, në bazë të pozicioneve të cekura si më poshtë:

1.1. Në Zyrën e Kryetarit, subvencione ndahen si vijon:

1.1.1 Subvencione për dekorata.....	3.000.00 €
1.1.2 Subvencione për raste të veçanta.....	3.000.00 €
Gjithsejtë.....	6000.00 €

2. Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale subvencionet ndahen për këto kategori:

2.1 Ndihmë me zahire familjeve skamnore.....	2.000.00 €
2.2 Ndihmë për strehim – qiratë.....	24.000.00 €
2.3 Ndihmë për shërim.....	24.000.00 €
2.4 Bashkëfinancim me donatorë për familjet e pastrehë.....	10.000.00 €

2.5 Financim të OJQ-ve.....25.000.00 €
Gjithsejtë.....85.000.00 €

3. Në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, subvencionet ndahen për këto kategori:

3.1. Botimi i librave, publikimeve.....2.000.00 €
3.2. Teatri i qytetit.....7.500.00 €
3.3. Financimi i OJQ-ve.....49.414.00 €
Gjithsejtë.....58.914.00 €

4. Në Drejtorinë për Arsim, subvencionet ndahen për këto kategori:

4.1. Bursa për studentë.....18.460.00 €
4.2. Përkrahje e nxënësve dhe studentëve për aktivitete të lira.....5.540.00 €
4.3. Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta.....9.000.00 €
Gjithsejtë.....33.000.00 €

Totali.....182.914.00 €

5. Mjetet e bartura (subvencionet) nga viti 2017.....55.000.00 €

6. Vlera e përgjithshme e mjeteve financiare të dedikuara për subvencione për vitin 2018 që janë shpërndarë nëpër drejtori komunale është.....237.914.00 €

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorja për Arsim, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa.

8. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit


Arsyetim

Mjetet buxhetore nga kategoria subvencione dhe transfere të aprovuara me buxhetin e komunës për vitin 2018, janë shpërndarë në vija buxhetore në Drejtorinë e Shëndetësisë, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe në zyrën e kryetarit sipas kategorive të cekura në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjithashtu janë paraparë mjete tjera nga kjo kategori në shumë prej 55.000.00 € të mbetura nga vitit 2017, të cilat do të mund të shfrytëzohen në vitin 2018.

Nga sa u cekë më sipër i propozohet kuvendit të komunës, që të aprovoj këtë propozim-vendim si në dispozitiv.

Lutfi Gerguri


Drejtore i DBF-së



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Datë: 02.02.2018

Për: KPF-në dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Nasuf Aliu

Lënda: Propozim-vendim

Në bazë të nenit 51.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 55.3 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.03/2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2018 mori këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

1. Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës së Vushtrri, në këtë përbërje:

- 1.1 _____ anëtar i kuvendit;
- 1.2 _____ anëtar i kuvendit;
- 1.3 _____ anëtar i kuvendit;
- 1.4 _____ anëtar i kuvendit;
- 1.5 _____ anëtar i kuvendit (komuniteti serb);
- 1.6 Radovan Petroviq, anëtar (komuniteti serb);
- 1.7 Berat Maxhuni, anëtar (komuniteti turk);
- 1.8 Adem Hoti, anëtar (komuniteti ashkali);
- 1.9 Gjemo Emini (komuniteti rom).

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.


3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Nasuf Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Arsyetim

Në vështrim të dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nga të cilat buron obligimi ligjor për themelimin e Komitetit për Komunitete, si dhe duke u bazuar në propozimet me shkrim të përfaqësuesve të komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën e Vushtrrisë, Kryesuesi i Kuvendit ka hartuar propozim-vendimin për themelimin e Komitetit për Komunitete. Andaj nga të cekurat me sipër i propozojmë KPF-së dhe Kuvendit të Komunës që ta aprovojë propozim-vendimin si në dispozitiv, duke u plotësuar edhe me propozimet nga anëtarët e kuvendit.


Nasuf Aliu
Kryesues i Kuvendit

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 468318

Nr. i fq. / Br. et. _____

Data: / Datum: 02.02.2018

VUSHTRRI - VUÇITRN





Republika e Kosoves
Republika Kosovo
Komuna Vushtrri
Opština Vuçitrn
Zyra komunale per komunitete dhe kthim
Opštinska kancelarija za zajednica i povratak

Data: 02.02.2018

Për : Kryetarin e Komunës z. Xhafer Tahiri

Nga : Zyra Komunale për Komunitete dhe kthim

Shef i ZKKK Branislav Vuksanovic 
Koordinatori për kthim – riatdhesim Ekrem Merovci 

Lënda : Plotsim i raportit 3404/18



Në bazë të kërkeses Nr 146/18 të datës 02.02.2018 i kërkuar nga Kryetari i Komunës z.Xhafer Tahiri për plotsim të raportit Nr 3404/ 18 të datës 25.01.2018 për zgjedhejen e perfaqësve të komunitetit rom për anëtar të Komitetit për komunitete dhe Kshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSB), komisioni i lartëshënuar iu paraqet këtë:

Konstatim

1. Procesi zgjedhorë konstatohet i rregullt
2. Në komitetin për komunitete është zgjedhur z. Gjemo Emini
3. Në kshillin Komunal për siguri në bashkësi (KKSB) është zgjedur z. Adnan Hodiqi

Arsyetim

Në vlersimin e lartëshënuar ku thuhet „ Për shkak të tollovisë së krijuar nuk kemi mundur ta mbajmë situatën nën kontrollë". Kjo ka qenë një situatë e diskutimeve dhe ideve verbale. Në procesin e propozimeve, votimit, numrimit të votave dhe shpalljes së rezultateve nuk ka pasur pengesa, që do të thot se në këtë proces nuk ka pasur ndikime apo parregullsi të cilat kanë ndikuar në rezultat të zgjedhjes së përfaqësve të lartëshënuar.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / №. 17 08/18

Nr. i fa. / Br. sht. _____

Data: / Datum 15-07-2018

VUSHTPRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrri
Opština Vuçitrn - Municipality of Vushtrri



Datum: 12.01.2018

OD: Opštinske kancelarije za zajednice i povratak – Opština Vuçitrn
Šef OKZP-a Branislav Vuksanović

ZA: Predsedavajući Skupštine opštine Vuçitrn
G- din. Nasuf Aliu



Predmet: Zapisnik sa održanog sastanka sa predstavnicima sela za izbor člana za Komitet za zajednice.

Na osnovu Vašeg zahteva broj 03/18 od dana 12.01.2018 godine, gde zahtevate da Opštinska kancelarija za zajednice i povratak organizuje sastanak sa predstavnicima seoskih odbora i njihovim članovima, kako bi se izvršio izbor člana za Komitet za zajednice.

Šef opštinske kancelarije za zajednice i povratak, sazvaio je sastanak dana 13.01.2018 godine u 13 časova u prostorijama Doma kulture u Prilužju, sa jedinom tačkom dnevnog reda:

- 1- Izbor člana za Komitet za zajednice

ZAPISNIK

Sastanak je otvorio Branislav Vuksanović Šef opštinske kancelarije za zajednice i povratak, gde je pozdravio predstavnike sela Prilužja i Graca kako i njihove članove (predstavnik sela Gojbulja nije prisustvovao sastanku). Obrazložio im je zahtev Predsedavajućeg skupštine opštine Vuçitrn za imenovanje člana iz redova srbske zajednice koji će da zastupa interese svoje zajednice na sastancima Komiteta za zajednice u Opštini Vuçitrn. Nakog obrazloženja otvorio je debatu.

Nebojša Zdravković- Presednik sela Prilužja: Obzirom na to da selo Prilužje u predhodnom sazivu Komiteta za zajednice imalo je prestavnika u tom skupštinskom telu, predlaže da se ovoga puta imenuje član iz sela Graca, i predložio je gospodina Radovana Petrovića.

Većinom članova seoskih odbora, podržali su predlog da Radovan Petrović iz sela Graca bude imenovan za člana Komiteta za zajednice u Opštini Vuçitrn.

Predsedavajući Branislav Vuksanović, zahvalio se na učešću na sastanku i čestitao na imenovanju Radovana Petrovića u poželio mu puno uspeha u daljem radu.

Sastanak je završen u 13:40

Zapisničar
Miljan Bojković



Republika e Kosovës
Republika Kosova



Komuna Vushtrri
Opština Vučitrn

Më : 12.01.2018

Nga: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – Komuna Vushtrri
Shefi i ZKKK-së, Branislav Vuksanović

Për: Kryesuesin e Kuvendit Komunal në Vushtrri - Z. Nasuf Aliu

Lënda : Procesverbal nga mbledhja e mbajtur me përfaqësuesit e fshatit për zgjedhjen e anëtarit të Komitetit për Komunitete.

Në bazë të kërkesës së juaj nr.03/18 nga data 12.01.2018 ku keni kërkuar që Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, të organizojë mbledhje me përfaqësuesit e këshillit të fshatit dhe anëtarët e tyre për të zgjedhur anëtarin e Komitetit për Komunitete.

Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, beri thirrje për një takim më : 13.01. 2018, në orën 13 në lokalet e Shtëpisë së Kulturës në Prelluzhë , vetëm me një pikë të rendit të ditës.

PROCESVERBAL

Mbledhjen e hapi Branislav Vuksanović, Shef i Zyres për Komunitete dhe Kthim, ku përshëndeti gjithë përfaqësuesit e fshatit Prelluzhë dhe Gracë si dhe anëtarët e tyre, (përfaqësuesi i fshatit Prelluzhë nuk morri pjesë në këtë mbledhje).Vuksanoviçiqi arsyetoi kërkesën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal Vushtrri për emërtimin e anëtarit nga radha e komunitetit serb, i cili do të përfaqësojë interesat e komunitetit të tij në mbledhjet e Komitetit për Komunitete në Komunën e Vushtrrisë. Pas arsyetimit hapi debatin lidhur me pikën e rendit të ditës.

Nebojsa Zdravkoviç- Kryetar i fshatit Prelluzhë, duke pasur parasysh se fshati Prelluzhë në mbledhjet e mëparshme të Komitetit për Komunitete kishte përfaqësuesin në këtë komitet, për këtë arsye propozoi që këtë herë të emërtohet anëtari nga fshati Gracë dhe për anëtarë të ri propozoi Radovan Petroviçin.

Me shumicën e votave nga anëtarët e këshillit të fshatit ,ata mbështetën propozimin që Radovan Petroviqi të emërohet për anëtarë të Komitetit për Komunitete në Komunën e Vushtrrisë.

Kryesuesi i mbledhjes Branislav Vuksanoviqi , falenderoi anëtarët në pjesmarrje , dhe përgëzoi për emërim Radovan Petroviqin duke i dëshiruar shumë suksese në punën e mëtejshme .

Mbledhja përfundoi në ora 13:40

Procesmbajtësi
Millan Bojkoviq

Procesë Verbal i mbledhjes zgjedhore për antarët e Komitetit për komunitete dhe KKSB mbajtur me datën 23.01.2018 në Vushtri.

- Në këtë takim ishin prezent 15 persona nga Komiteti Ashkel, Mbledhjen e hapuri z. Adem Hoti i cili propozoi këtë rendite.

1. Zgjedhja e Antarit për Komitet për Komunitete.
2. Zgjedhja e Antarit për KKSB.

- Nga të pranishmit u propozua Adem Hoti të jetë antarë për Komitet për Komunitete,
- Ndërsa për të KKSB u propozua Valdet Zymeri.
Votimi u mbajtur në mënyrë të hapurë dhe u aprovuan nga të pranishmit një zërit dhe nuk pati asnjë kundërshtim.

23.01.2018. Proces Verbalin e mbajtur.
Vushtri. Muharem Prustemi

Lista e pjesëmarrësve në takimin e
komitetit Askkali për propozimin të autorve
për komitet për komitete dhe keshilli komitet
për siguri në bashkësi

Emri Mbiemri

Hemolbrimi

1. AMET DRAMISHI 1004593002 D. DRAMISHI

2. SHYHRETE DRAMISHI 1010692853 SHYHRETE DRAMISHI

3. XHEVAT DRAMISHI 1241824582 XHEVAT

4. MUHAMMEDI KRUSTEMI 1021569755

5. KOLMANI FADIL 1173035043

6. Bekim Cuni 1172181968

7. Afërdita Cuni 1172181976

8. Hatmit Zymeri 1170810615

9. Valdet Zymeri 2171882217

10. SHANI DUKA 1016792540

11. SHAKRI DUKA 1016792558

12. HRGJEVAM DUKA 1231753628

13. FEMI DRAMISHI 1016792248

14. Salih Hoti 1173032516

15. SAMIJE HOTI 1004619727

Handwritten signatures and initials corresponding to the list entries.

Për : KUVENDIN KOMUNAL – VUSHTRRI
NGA : KDTP – DEGA VUSHTRRI
NË : VUSHTRRI

kerkes

Kryesia e Partisë Turke KDTP – Dega në Vushtrri, në mbledhjen e fundit të mbajtur me datën 01.05.2018 morën vendim, që Në Komitetin për Komunitete të emërohet z. Berat Maxhuni, kurse në Këshillin Komunal për Siguri z. Abdulla SUNGUR .

Ky vendimi është marrë nga mbledhja e fundit e kryesis së degës të datës 01.05.2018 si rrjedhojë e zgjedhjeve të fundit të degës sonë.

Berat Maxhuni

Sekretar i Degës së KDTP - së



* KDTP - VHS-leri Subesi Toplantı

1. Son Gelismeler

2. Gecitli

1. Abdullah Sengun

Sengun

2. Myzejeme Roba

R.

3. Tehniye Kora

Kora

4. Urgan, Ahmet "Gp"

Urgan

5. ERGIN BUATAN


Egin Basayak Zastuntor Son Gelismelerde
Fikrim Demke ve Mustafa Sinik Mahir Juyelom
istifasini utedi.

Azmi Zananda Belediye Temsilcileri Azimlikas
Komitesinde Becut Maxhan. temsil etmosi kusari

Calindi ve Gultentik Komitesinde (Siyasi) Abdulla
Sungus temsil etmosi icin kusari alindi.

05-01-2018

Sube Sedretori





REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës



Datë: 13.02. 2018

Për: Kuvendin Komunal

Propozues: Kryetari i Komunës, Xhafer Tahiri

Hartues: Drejtoria për Shërbime Publike, Sedat Rashica

Për shqyrtim: Propozim – Vendim për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve

Bazuar në nenin 12.2, pika (d) të Ligjit 03/L- 40 mbi Vetëqeverisje lokale, nenit 5.2 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe Nenit 41.2 pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2018, mori këtë:

V E N D I M

për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve

- Me këtë vendim emërohen anëtarët e Komisionit komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Rajonale të Mbeturinave „Uniteti” Sh.A. Mitrovicë, për Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 _____, anëtar i Kuvendit;
 - 1.2 _____, anëtar i Kuvendit;
 - 1.3 _____, anëtar i Ekzekutivit;
- Komisioni Komunal i Aksionarëve, kompetencat dhe përgjegjësitë e tij i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike, Ligjit për Shoqëritë Tregtare si dhe akteve tjera juridike në fuqi me të cilat është rregulluar kjo çështje.
- Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike.
- Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Nasuf Aliu

Arsyetim

Kur një komunë është aksionar në një Ndërmarrje Publike, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohen nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar.

Komisioni Komunal i Aksionarëve i secilës komunë do të përgatisë dhe nxjerrë një politike të pronësisë e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të komunës në lidhje me pronësinë e Ndërmarrjes Publike si dhe rolin e saj në qeverisjen korporative të tyre. Kjo politikë e pronësisë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe dispozitat tjera të aplikueshme ligjore në Kosovë. Kjo politikë e pronësisë po ashtu duhet të përmbajë dispozita të hollësishme mbi mënyrën e zbatimit të saj. Pasi që në këtë ndërmarrje publike posedojnë aksione më shumë se një komunë, Komisionet përkatëse Komunale të Aksionarëve do të bashkëpunojnë ngushtë për përgatitjen e një politike të përbashkët të pronësisë. Në rast se nuk mund të arrihet marrëveshje në lidhje me një element përmbajtësor të politikës së përbashkët të pronësisë, çështja do të vendoset me shumicën e votave të Komisioneve përkatëse Komunale të Aksionarëve.

Aksionarët e Ndërmarrjes Publike do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë.

Duke qenë se mandati i anëtarëve të Komisionit të kaluar, ka skaduar me rastin e konstituimit të Kuvendit të ri dhe Qeverisë së re komunale, është paraqitur nevoja e emërimit të anëtarëve të ri të këtij komisioni për mandatin aktual.

Prandaj i kemi propozuar Kuvendit Komunal që të emëroj anëtarët e këtij komisioni, pra dy përfaqësues nga Kuvendi Komunal dhe një anëtar nga Qeveria Komunale.

Drejtori i Drejtorisë




Sedat Rashica



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A	31.1.2018
PËR/ZA/TO:	KPF-në dhe KK VUSHTRRI
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, drejtor Sylejman Meholli 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë për gjendjen në shëndetësi

Duke u bazuar në Planin Vjetor të Punës së Kuvendit për muajin shkurt 2018, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, paraqet këtë:

INFORMATË

lidhur me gjendjen në shëndetësi në Komunën e Vushtrrisë

Kujdesi parësor shëndetësor në Vushtri ofron shërbime shëndetësore përmes Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe qendrave tjera shëndetësore për më shumë se 70.000 banorë. Këto shërbime shëndetësore, qytetarët i marrin në shumicën e rasteve në afërsi të vendbanimit të tyre.

QKMF Vushtri ofron shërbime shëndetësore në 10 qendra shëndetësore (QMF), tri (3) nga to janë të vendosura në qytetin e Vushtrrisë dhe në një mënyrë qyteti është ndarë në katër zona me qëllim që qytetarët të marrin shërbime shëndetësore të qasshme dhe cilësore sa më afër vendbanimit të tyre, si dhe shtatë (7) nëpër fshatra. Rrjeti i institucioneve shëndetësore përveç qendrave shëndetësore (QMF), ka edhe 9 ambulanta të mjekësisë familjare (AMF) që janë të vendosura në viset rurale. Në këto AMF stafi i infermierisë punon 5 ditë në javë, ndërsa mjeku punon tri e në disa raste dy herë në javë në varësi nga numri i banorëve në zonën ku gjendet ambulanta e mjekësisë familjare, në ç'rast kushtëzohet edhe nga numri i vogël i stafit shëndetësor e sidomos mjekëve dhe pamundësia e rritjes së numrit të stafit në proporcion me numrin e banorëve dhe nevojës për shërbime shëndetësore. Në AMF- Skromë dhe Zhilivodë për shkak të vështirësisë së terrenit dhe mungesës së transportit, mjeku dhe infermieri dërgohen vetëm një herë në javë me veturën e QKMF-së, kurse në këto dy AMF numri i pacientëve është shumë i vogël sidomos në AMF Zhilivodë.

- Iu njoftojmë se gjatë periudhës dymbëdhjetëmuajshe, nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2017, në QKMF dhe në qendrat tjera shëndetësore ka pasur gjithsej 209.912 vizita mjekësore, kështu që nga totali 94.973 kanë qenë pacientë që i përkasin gjinisë mashkullore, ndërsa të gjinisë femërore kanë qenë 114.939 pacientë. Pacientët që kanë kërkuar shërbime shëndetësore janë të të gjitha moshave, prej 0 vjeç deri të moshat e shtyra, si dhe deri në përfundim të jetës.

Janë ofruar gjithsej 509.700 shërbime të ndryshme shëndetësore për të gjithë qytetarët e Vushtrrisë pa dallim moshe, gjinie, feje dhe etnie. Përveç shërbimeve në

institucionet shëndetësore në komunën tonë, stafi i QKMF- së ka kryer edhe vizita shtëpiake te pacientët e sëmurë rënd dhe të palëvizshëm, kurse numri i këtyre vizitave arrin shifrën 1.118. Po ashtu nga mjekët familjarë janë raportuar 8.846 raste të sëmundjeve kronike, ndërsa numri i sëmundjeve malinje i raportuar është 440 pacientë, të cilët nuk janë raste të reja, por raste që kanë marrë shërbim shëndetësor tek ne. Numri i pacientëve me sëmundje kronike po rritet gjithnjë e më shumë për fat të keq edhe pse nuk kemi një shifër të saktë për shkak të mungesës të shërbimit informativ shëndetësor në Kosovë. Nga muaji maj deri në muajin dhjetor nga mjekët familjarë janë raportuar 3.928 pacientë të vizituar me Diabet të tipit II (kuptohet janë raste të përsëritura), ndërsa pacientë insulinavartës deri më tani janë të raportuar 590, nga ta 8 janë fëmijë.

- Furnizimi me insulina bëhet nga M.SH dhe fatkeqësisht nuk furnizohemi në sasi të mjaftueshme për pacientët që kanë nevojë, d.m.th më pak se sasia e kërkuar nga ne për nevoja të pacientëve tanë. Pas furnizimit me insulina bëhet shpërndarja e tyre përmes barnatores qendrore në QKMF dhe QMF, duke i llogaritur njësitë që i kanë të nevojshme dhe ordinare nga mjeku i pacientit. Prandaj kemi pas disa vështirësi në furnizimin me terapi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë e sidomos mungesa e insulinave, për shkak se pacientët insulinavartës e kanë të domosdoshme terapinë me to, dhe këto mungesa shkaktojnë pakënaqësi dhe nga ne kërkojnë përgjegjësi në QKMF, megjithëse ne bëjmë vetëm shpërndarjen sa më të drejtë të tyre.
- Furnizimi me barna nga lista esenciale ka pas ngritje dhe rënie. Nëntori ka qenë muaji më i dobët me furnizim nga M.SH nga shuma e kërkuar e terapisë dhe materialit shpenzues 20.619.47 euro terapi dhe material tjetër shpenzues që kemi kërkuar, kurse kemi pranuar vetëm 7.713.87 euro apo vetëm 37.41 % e terapisë së kërkuar që na ka shkaktuar vështirësi. Muaji me furnizim më të mirë me terapi ka qenë janari i vitit 2017, ku kemi kërkuar 20.790.30 euro, ndërsa na kanë furnizuar me 20.240.51 euro ose në përqindje 97.35% të terapisë. Gjatë vitit të kaluar kemi kërkuar nga M.SH buxhet për medikamente dhe material shpenzues 244.894.73, për plotësimin e nevojave për pacientët që marrin shërbime në QKMF. Nga këto janë realizuar vetëm 189.025.32 euro apo shprehur në përqindje 77.18%, ndërsa nga buxheti i QKMF-së përmes kontratës që kemi realizuar me një kompani farmaceutike, jemi furnizuar me terapi dhe material shpenzues që i takojnë listës esenciale 20.100.86 euro, dhe kështu kemi pasur plotësim deri diku të kërkesave të qytetarëve edhe pse

nevojat janë shumë të mëdha për terapi. Gjithashtu mbajtja e emergjencës me staf dhe terapi na shkakton vështirësi të mëdha dhe na e rëndon gjendjen në QKMF, QMF dhe AMF në komunën tonë.

Pas marrëveshjes në mes të “Islamic Relief” dhe komunës tonë, ofrimi i vizitave në shtëpi ka qenë i kënaqshëm dhe shumë i dobishëm për komunitetin, të cilët kanë pas vështirësi në qasjen e shërbimeve tona. Ky bashkëpunim ka filluar nga qershori i vitit 2017, në ç’rast janë ofruar vizita për pacientët dhe shërbime në shtëpitë e tyre, duke qenë sa më afër me shërbime. (Këto vizita dhe shërbime janë bërë në koordinim me stafin e QKMF). Në komunitet është ofruar edukim shëndetësor, vizita dhe shërbime profesionale në shtëpi për personat që kanë pas nevojë. Me theks të veçantë shtatzënat, lehonat dhe i porsalinduri, personat me sëmundje kronike, si dhe ata që janë në gjendje terminale/paliative. Gjithsej vizita dhe edukim shëndetësor për këta 7 muaj janë 9.501 dhe 14.457 shërbime të ndryshme shëndetësore me terapi, në të shumtën e herëve falas, terapi nga lista esenciale. Gjatë vitit 2017 nga bashkëpagesat kemi të hyra 47.126 euro, të cilat janë si rezultat i bashkëpagesave që bëhen për vizitë mjekësore, për shërbime diagnostike, certifikata shëndetësore, raporte mjekësore etj. Po ashtu nuk jemi të kënaqur me participimin që realizohet përmes bashkëpagesave, por duke u krahasuar me komunat fqinje jemi shumë më mirë me bashkëpagesa. Vështirësi në realizimin e të hyrave na shkakton numri i madh i kategorive që lirohen me anë të librezave të ndryshme, si dhe mosspecifikimi i qartë me udhëzim administrativ për kategoritë që lirohen.

QKMF- përbëhet nga dy departamente:

Departamenti i mjekësisë familjare dhe Departamenti i administratës.

Departamenti i mjekësisë familjare është i ndarë në disa sektorë:

- Në *sektorin e mjekësisë familjare* bëhet punë e madhe nga profesionistët shëndetësorë, 18 nga ta janë specialistë të mjekësisë familjare dhe 17 mjekë familjarë. Në këtë sektor ofrohen vizita mjekësore, edukim dhe promovim shëndetësor për pacientin, diagnostikim dhe trajtim të sëmundjes dhe shërbime që kanë të bëjnë me trajtimin e saj. Shërbime si në tretman, infuzione, lidhtore, inhalim, këndi i rehidrimit, këshillimore për planifikim familjar dhe së bashku me AQH edukim dhe promovim shëndetësor për sëmundje kronike jongjitëse (Diabet dhe Hipertension), që pritet të fillojë implementimi në muajin mars 2018.
- Në kuadër të *sektorit të shëndetit publik* është shërbimi i SISH, imunizimi, vaksinimi e po ashtu luan rol të rëndësishëm në edukim dhe parandalim të

sëmundjeve infektive, e nëse vije deri te paraqitja e tyre, atëherë rekomandon marrjen e masave kundërepidemike. Është me rëndësi të theksohet se shërbimi i vaksinimit është ndër më të mirët në Kosovë, prandaj gjatë këtij viti ku ishte shfaqur epidemi e fruthit, fatmirësisht në komunën tonë ka pas vetëm tri (3) raste të dyshuara për fruth, me vetëm një rast të fruthit. Ky shërbim përpos vaksinimit të rregullt sipas kalendarit të vaksinimit të fëmijëve, ka planifikuar të vaksinojë edhe fëmijët e klasave të para, gjithsej 1.093 (janë vaksinuar të gjithë), janë vaksinuar edhe fëmijë të komunitetit ashkali, të cilët i janë përgjigjur pozitivisht thirrjes. Po ashtu për çdo vit realizon me sukses vaksinimin e personave të moshuar dhe atyre me sëmundje kronike me vaksinë të gripit, ku janë vaksinuar 3.200 qytetarë. Gjithashtu vaksinohen edhe qytetarë tjerë që kanë nevojë, p.sh pas lëndimeve apo ndonjë gjendjeje tjetër.

- *Spektori i shëndetit oral* ofron shërbime shëndetësore në QKMF dhe QMF-1 në dy ndërrime, ndërsa në QMF-2 dhe QMF-3 punohet dy herë gjatë javës vetëm në ndërrimin e paraditës për shkak se nuk ka staf të mjaftueshëm profesional (stomatologë) dhe bazuar në këtë në shërbimin e stomatologjisë janë vizituar 8.667 pacientë, në ç'rast janë ofruar 26.001 shërbime, ka pasur 3.417 ekstrakcione të dhëmbëve, ndërsa për dhëmbë të bllobuar kanë qenë 1.040 pacientë, si dhe ka pasur edhe 3.855 intervenime tjera dhe 111 vizita të përsëritura.
- *Shërbimi diagnostikues* ku bëjnë pjesë laboratorit dhe RO - laboratorit ka pas disa vështirësi objektive dhe subjektive, por ka ofruar numër të madh të shërbimeve shëndetësore, dhe ankesat e qytetarëve kanë qenë për pamundësi të bërjes së analizave kur kanë pas nevojë për to, ndërsa stafi është ankuar për fluks të madh të pacientëve. Gjithsej janë kanë qenë 14.498 pacientë, nga ta kanë participuar 3.115 pacientë (9.185 E) dhe janë ofruar gjithsej 163.528 shërbime.
- *Shërbimi i radiologjisë* gjithashtu ka bërë një punë të mirë gjatë gjithë vitit, duke iu ofruar shërbimet e kërkuara pacientëve të tyre pa problem dhe ngecje. Gjate vitit janë vizituar 5.520 pacientë, nga ta kanë participuar 1.303, ndërsa janë ofruar 15.609 shërbime të ndryshme radiologjike.
- *Shërbimi i urgjencës* është shërbim që ofrohet në objektin e QMF- 1 nga ora 7 deri në ora 21. Në këtë shërbim janë vizituar 7.991 pacientë, nga ta kanë participuar 1.677 pacientë dhe janë ofruar 4.129 shërbime.

- *Shërbimi i emergjencës* është shërbim që ofrohet në objektin e spitalit "Sheik Zayhed" nga stafi i QKMF-së edhe pse me udhëzim administrativ të lëshuar nga M.SH, kujdesi parësor duhet të jep vetëm shërbime urgjente pasi që nuk ka kompetencë profesionale. QKMF i ka dalë në ndihmë spitalit pasi ka pas mungesë stafi dhe besojmë se nga muaji shkurt i vitit 2018 ne do të ofrojmë shërbime urgjente për qytetarët e komunës tonë, ndërsa shërbimet emergjente do të ofrohen nga stafi i spitalit "SH.Z". Gjatë vitit 2017 në shërbimin emergjent janë vizituar gjithsej 29.158 pacientë, 760 nga ta kanë marrë ndihmën e parë dhe janë transferuar në Qendrën Emergjente në Prishtinë. Po ashtu në këtë qendër janë ofruar 116.630 shërbime dhe kanë participuar 4.884 pacientë, si dhe ekipi në fjalë ka vizituar dhe ka konstatuar 111 vdekje për të cilat ka lëshuar certifikatë vdekjeje.


Gjate vitit 2017, rrjetit të institucioneve shëndetësore i janë shtuar edhe dy qendra të reja shëndetësore moderne QMF-2 afër shkollës "Andon Zako Çajupi" e cila është funksionalizuar në mars të vitit 2017 dhe QMF-3 që është funksionalizuar në dhjetor dhe ka qenë donacion i një shoqate joqeveritare të Kuvajtit, përmes Bashkësisë Islame Vushtrri, e cila ka startuar shumë mirë.

Përfundim


Gjendja shëndetësore sa i përket vitit 2017 në Komunën e Vushtrrisë nuk ka qenë e keqe. E gjithë kjo duke iu referuar raporteve kthyesë nga IRSHP Mitrovicë. Këto raporte merren nga profesionistë shëndetësorë të QKMF - Vushtrri dhe raportohen në IRSHP, ku përpunohen dhe kthehen në QKMF si të dhëna të verifikuara.

Në Kosovë gjatë vitit 2017 është paraqitur epidemia e fruthit dhe IKSHP në Prishtinë shpalli gjendje të jashtëzakonshme, ndërsa në Komunën e Vushtrrisë si rezultat i punës së mirë patëm vetëm disa raste të paraqitura si të dyshimta e me vonë tri (3) nga to të verifikuara me fruth. Kjo na bën të ndihemi mirë me punën që po bëhet në shumë sektorë të mjekësisë familjare e në veçanti në shërbimin e vaksinimit, i cili ka marrë vlerësime edhe nga IKSHP Prishtinë.

Si qeverisje e re për mandatin 2018-2021 kemi shumë sfida në përmirësimin e gjendjes së shëndetësisë në komunën tonë. Për muajin e parë të qeverisjes konsiderojmë se kemi filluar mbarë duke hequr kufizimin e punës së laboratorit, duke rritur monitorimin e institucioneve shëndetësore për t'i mbajtur llogaridhënëse për shërbimet dhe obligimet që kanë; kemi vazhduar bashkëpunimin me AQH-në zvicerane në mënyrë që të përfitojmë sa më shumë donacione dhe programe nga fusha e shëndetësisë nga ta; jemi në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e “Islamic Relief” për vazhdimin e bashkëpunimit dhe për lidhjen e një memorandumi të ri për vizitat mjekësore në shtëpi e cili besojmë se do të finalizohet shumë shpejt. Me Planin e punës për vitin 2018 kemi paraparë përmirësimin e shërbimeve; zhvillimin e vazhdueshëm profesional për kuadrot ekzistuese; sigurimin e vaksinimit të vazhdueshëm; sigurimin e vizitave sistematike të nxënësve, edukimin e popullatës, duke fuqizuar komponentët e parandalimit të sëmundjeve, realizimin e investimeve kapitale të parapara për këtë vit etj.



REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI



DREJTORIA E ARSIMIT

DATE /A:	02.02.2018
REFERENCË:	10 Nr. / 2018
PËRZATO:	KPF-në dhe Kuvendin Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Arsim, drejtori Afrim Namani
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018



Në bazë të Ligjit Nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 7 dhe në bazë të Statutit të Komunës së Vushtrisë, DA paraget këtë informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018.

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Suksesi i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm.....	4
Suksesi i nxënësve në nivelin e arsimit fillor (I-V).....	5
Suksesi i nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX).....	8
Suksesi i nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të lartë (X-XII).....	11
Suksesi i arritur i nxënësve për secilën lëndë.....	14
Vijueshmëria e nxënësve.....	17
Përfundim.....	21

Hyrje

Marr parasysh rëndësinë dhe nevojën për një arsim cilësor, Drejtoria e Arsimit, në fund të këtij gjysmëvjetori ka bërë një vlerësim dhe analizë të përgjithshme për ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor dhe analizën e suksesit të nxënësve për rezultatet e arritura, për të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Arsimit ka përcjell ecurinë e procesit arsimor, duke bashkëpunuar me institucione dhe organizata të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies. Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme - shoqërisë së dijes, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies në procesin edukativo-arsimor. Gjithashtu drejtoria do të punojë në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënojnë progres dhe të arrijnë në nivelin e shkollave të përparuara, si në mësimitdhënie, në mësimitnxënie dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.

SUKSESI I NXËNËSVE NË ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM

Komuna e Vushtrrisë ka gjithsej 3 shkolla fillore dhe 27 shkolla të kombinuara fillore dhe të mesme të ulëta amë, me 16 paralele të ndara fizike, 2 shkolla të mesme të ulëta, si dhe 3 shkolla të mesme të larta, prej tyre 2 të arsimit profesional. Në këto shkolla, në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017/18, në nivelin fillor e kanë vijuar mësimin 4288 nxënës, të shpërndarë në 286 paralele, që i bie mesatarisht 15.00 nxënës për paralele. Në nivelin e mesëm të ulët kanë vijuar mësimin 4663 nxënës, të shpërndarë në 216 paralele, që i bie mesatarisht 21.58 nxënës për paralele, kurse në nivelin e mesëm të lartë kanë vijuar mësimin 3481 nxënës, të shpërndarë në 127 paralele, që i bie mesatarisht 27.40 nxënës për paralele.

Në këtë numër të përgjithshëm të nxënësve nuk janë përfshirë 828 nxënës të nivelit parafillor nëpër shkolla dhe 175 fëmijë në çerdhe.


SUKSESI I ARRITUR I NXËNËSVE NË NIVELIN FILLOR

Në nivelin fillor të arsimit në Komunën e Vushtrrisë kanë qenë 5347 nxënës me sukses pozitiv apo 96.24 %, 26 me sukses të pamjaftueshëm, 0.47- % dhe 4 nxënës të panotuar, 0.047 %,


Suksesi sipas vlerësimit të përgjithshëm përfundimtar është:

- me sukses të shkëlqyeshëm 3436 nxënës ose 63.90 %;
- me sukses të shumë mirë 1105 nxënës ose 19.89 %;
- me sukses të mirë 624 nxënës ose 11.23 %;
- me sukses të mjaftueshëm 182 nxënës ose 3.27 %;
- me sukses pamjaftueshëm gjithsej 26 nxënës ose 0.47 %;
- të panotuar 4 nxënës ose 0.072 %.

Grafiku pasqyron suksesin e përgjithshëm të nxënësve, të arritur në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017/2018 për nivelin fillor të arsimit:



Grafiku pasqyron krahasueshmërinë e suksesit të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/2018, me periudhën e njëjtë të vitit shkollor 2016/2017 për nivelin fillor:




SUKSESI I ARRITUR I NXËNËSVE NË NIVELIN E MESËM TË ULËT

Në nivelin fillor të arsimit në Komunën e Vushtrisë kanë qenë 3410 nxënës me sukses pozitiv apo 73,12 %, 1240 me sukses të pamjaftueshëm ose 26,04 % dhe 13 nxënës të panotuar ose 0.27 %.


Suksesi sipas vlerësimit të përgjithshëm përfundimtar është:

- me sukses të shkëlqyeshëm 1039 nxënës ose 22,28 %;
- me sukses të shumë mirë 1078 nxënës ose 22,63 %;
- me sukses të mirë 1062 nxënës ose 22,3 %;
- me sukses të mjaftueshëm 231 nxënës ose 4,85 %;
- me sukses të pamjaftueshëm gjithsej 1240 nxënës ose 26,04 %;
- të panotuar 13 nxënës ose 0.27 %.

Grafiku pasqyron suksesin e përgjithshëm të nxënësve, të arritur në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017/2018 për nivelin fillor të arsimit:



Grafiku pasqyron krahasueshmërinë e suksesit të nxënësve, të arritur në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017/2018, me periudhën e njëjtë të vitit shkollor 2016/2017 për nivelin e mesëm të ulët të arsimit:




SUKSESI I ARRITUR I NXËNËSVE NË NIVELIN E MESËM TË LARTË

Në nivelin e mesëm të lartë të arsimit në Komunën e Vushtrisë kanë qenë 1336 nxënës me sukses pozitiv apo 37.41 %, 2134 me sukses të pamjaftueshëm, 59,75 % dhe 11 nxënës të panotuar 0.3 %;


Suksesi sipas vlerësimit të përgjithshëm përfundimtar është:

- me sukses të shkëlqyeshëm 204 nxënës ose 5,89 %;
- me sukses të shumë mirë 502 nxënës ose 14,05 %;
- me sukses të mirë 533 nxënës ose 14,92 %;
- me sukses të mjaftueshëm 97 nxënës ose 2,71 %;
- me sukses pamjaftueshëm gjithsej 2134 nxënës ose 59,75 %;
- të panotuar 11 nxënës ose 0.3 %.

Grafiku pasqyron suksesin e përgjithshëm të nxënësve, të arritur në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017/2018 në nivelin e mesëm të lartë të arsimit:



Grafiku pasqyron krahasueshmërinë e suksesit të përgjithshëm të nxënësve, të arritur në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017/2018, me periudhën e njëjtë të vitit shkollor 2016/2017 në nivelin e mesëm të lartë të arsimit:




Suksesi i arritur për secilën lëndë


Drejtoria e Arsimit në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2017/18, ka realizuar një analizë të përgjithshme të suksesit dhe rezultateve të nxënësve të arritura në secilën lëndë.

Tabela dhe grafiku:

Grafiku pasqyron krahasueshmërinë e arritur në secilën lëndë, në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017/2018, me periudhën e njëjtë të vitit shkollor 2016/2017 në nivelin fillor:




Grafiku pasqyron krahasueshmërinë e arritur në secilën lëndë, në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2017/2018, me periudhën e njëjtë të vitit shkollor 2016/2017 në nivelin e mesëm të ulët:




Vijueshmëria e nxënësve


Grafiku pasqyron krahasueshmërinë për nxënës, për gjysmëvjetorin e parë të vitit 2017/2018, me periudhën e njëjtë të vitit 2016/2017 nga klasa I-V:



Grafiku pasqyron krahasueshmërinë për nxënës, për gjysmëvjetorin e parë të vitit 2017/2018, me periudhën e njëjtë të vitit 2016/2017 nga klasa VI-IX:



Grafiku pasqyron krahasueshmërinë për nxënës, për gjysmëvjetorin e parë të vitit 2017/2018, me periudhën e njëjtë të vitit 2016/2017 nga klasa X-XII:



Përfundim

Nga të dhënat statistikore të prezantuara më lart, mund të konstatojmë se në përgjithësi, suksesi është i kënaqshëm në të tri nivelet e arsimit, posaçërisht në nivelin e parë dhe të dytë, dhe po ky sukses rreth mesatares sillet edhe në nivelin e tretë. Megjithatë, duhet

cekur se çështja më problematike dhe sfiduese te vlerësimi është vërtetësia e rezultateve, sepse në praktikën mësimore shpesh po kemi vlerësim të pastandardizuar e që këtë proces e bën jo të besueshëm. Dallimet në mes të shkollave dhe mësimdhënësve, nota mesatare shumë e lartë në shkollat tona, pra marr në tërësi dhe krahasuar edhe me vitet paraprake, konstatojmë se ende nuk kemi arritur një progres të duhur drejt standardizimit të procesit të vlerësimit, si një standardizim dhe qëndrueshmëri konstante të arritshmërisë në mësim. Këtu mungojnë edhe analizat profesionale mbi këto dallime të mëdha në mes vlerësimit të brendshëm dhe shtrohen pyetje si: A është vlerësimi i brendshëm ende jashtë standardit të dëshiruar?.

Rekomandime

1. Vlerësimi i brendshëm duhet të ngrihet në nivelin e standardit të meritës;
2. Të sigurohet mbështetje shkollave për përdorimin e standardeve në arsim dhe zbatimin e kritereve të vlerësimit, si dhe aftësimi i mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave në fushën e vlerësimit të nxënësve, vlerësimit të performancës së shkollës dhe vetëvlerësimit;
3. Të shtohen kompetencat dhe përgjegjësitë e shkollës;
4. Të intensifikohet bashkëpunimi me prindër, njoftimi me kohë lidhur me mungesat e nxënësve, zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të avancimit të procesit mësimor, masat disiplinore, fushata dhe aktivitete vetëdijesimi etj.